

VENDIM
Nr.53, datë 15.9.2006

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE PËR SHOQËRINË “MAKSI ELEKTRIK” SHPK
PËR VITIN 2006**

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 26, pika 1, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, me ndryshimet përkatëse, neni 11 germa A, dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.60, datë 29.12.2004 “Të dhënat bazë në lidhje me aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël”, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 15.9.2006, pasi shqyrtoj aplikimin e shoqërisë “Maksi Elektrik” sh.p.k. për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2006 dhe konstatoi se plotëson kërkesat formale të paraqitjes së një aplikimi,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Maksi Elektrik” sh.p.k. për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2006.
 2. Ngarkohet Departamenti i Tarifave dhe i Çmimeve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta